

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Çfarë janë Dhomat e Specializuara të Kosovës?

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) janë një gjykatë në Hagë, Holandë, me gjykatës dhe personel ndërkombëtar.

Kjo gjykatë mund të gjykojë persona të akuzuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera në bazë të ligjit të Kosovës të cilat pretendohen të jenë kryer midis **1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000** dhe kanë lidhje me pretendimet e Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të 7 janarit 2011.

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

P.O. Box 47
2501 CA The Hague
The Netherlands



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEČA KOSOVA

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

PJESËMARRJA
E VIKTIMAVE

www.scp-ks.org

PJESËMARRJA E VIKTIMAVE

Kush mund të jetë viktimë pjesëmarrëse para DHSK-së?

Pas konfirmimit të një aktakuze, një gjykatës i DHSK-së mund të marrë vendim që një person, i cili ka përjetuar dëm fizik, mendor apo material si pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të përmendur në aktakuzën e konfirmuar, të mund të pranohet si viktimë pjesëmarrëse. Personi në fjalë duhet të ketë vuajtur dëm si pasojë e krimeve të kryera midis 1998 dhe 2000 dhe që kanë lidhje me pretendimet e Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të 7 janarit 2011.

Si bëhet kërkesa për pranim si viktimë pjesëmarrëse?

Kur të vijë koha, një person që pretendon se është viktimë do të duhet t'i dërgojë DHSK-së një formular kërkesë.

Formulari i kërkesës së bashku me udhëzimet për plotësimin e kërkesës gjenden në www.scp-ks.org. Të gjitha kërkesat shqyrtohen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

Kur do të jetë e mundur të paraqitet kërkesa?

Personat që dëshirojnë të pranohen si viktima pjesëmarrëse, kërkesën përkatëse mund ta bëjnë pasi gjykata të ketë publikuar aktakuzën.

A kanë avokat viktimat pjesëmarrëse?

DHSK-ja cakton mbrojtës me përvojë për përfaqësimin e një grupi viktimash pjesëmarrëse.

Çfarë bën mbrojtësi i viktimave?

Në përfaqësimin e një grupi viktimash, mbrojtësi i viktimave mund të bëjë deklaratë në nisje dhe në fund të gjykimit dhe të ketë qasje në materialet e çështjes. Gjithashtu, gjykatësit mund ta lejojnë mbrojtësin e viktimave të jetë i pranishëm në seanca gjyqësore, të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim, t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe në rrethana të caktuara të paraqesë prova që kanë lidhje me pasojat e krimeve të pretenduara mbi viktimat.

Mbrojtësi i Viktimave i informon rregullisht viktimat në lidhje me çfarë ndodh gjatë gjykimit dhe kërkon mendimet e dëgjon shqetësimet e tyre në lidhje me gjykimin. Mbrojtësi i Viktimave mund t'u paraqesë gjykatësve shqetësimet e viktimave.

A kanë të drejtë për zhdëmtim viktimat pjesëmarrëse para DHSK-së?

Në fund të gjykimit, gjykatësit mund të nxjerrin vendim mbi dëmet, humbjet dhe lëndimet e viktimave, i cili mund të shërbejë si bazë për një vendim të mëtejshëm për zhdëmtim. Zhdëmtimi mund të jetë kolektiv ose individual.

Si mund ta kontaktoni Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave të DHSK-së?

Shefe e Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave
Znj. **Silke Studzinsky**

ADRESË:
**P.O. BOX 47, 2501 CA, THE HAGUE
THE NETHERLANDS**

E-MAIL:
VPO@SCP-KS.ORG